

VENDIM
Nr. 80, datë 8.2.2017

**PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA
SHIJAK, TË PRONËS NR. 1131, ME
EMËRTIM “ISH-SPITALI”, ME VENDNDODHJE NË SHIJAK, DHE PËR NJË NDRYSHIM
NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË
MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR, DHE NË VENDIMIN NR. 839, DATË 22.7.2009, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS
PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË
TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM
TË BASHKISË SHIJAK,
TË QARKUT TË DURRËSIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Shijak, të pronës nr. 1131, me emërtim “Ish-spitali”, me vendndodhje në Shijak, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për ndërtimin e një qendre të shërbimeve të integruara, për realizimin e funksioneve dhe të shërbimeve administrative, ekonomike, socialkulturore, të shëndetit publik dhe për kryerjen e funksioneve të veta, në interes të komunitetit në territorin e Bashkisë Shijak.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, të hiqet prona nr. 1131, me emërtim “Ish-spitali”, me vendndodhje në Shijak, dhe të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore publike, që i kanë kaluar në pronësi ose në përdorim Bashkisë Shijak, me vendimin nr. 839, datë 22.7.2009, të Këshillit të Ministrave.

3. Bashkisë Shijak i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës nr. 1131, me emërtim “Ish-spitali”, me vendndodhje në Shijak, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë atë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkia Shijak për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Irona nr. 1131 "Ish Spitali Ushtarak" Shijak, Durris

Gjeneral Brigadë **MOJIB CAHANI**

Zona K,ldMtr. &e 19H.
Nr.Ptnurle Voi. Fq
Indcklll Hnco K(-).1.88(243A)
Shkllll 1 1000
Adieutp. surim Ol,e.
Sll*ak. Durres
P-onari

Zona KldMtr. &e I9H.
Nr.Ptnurle Voi. Fq
Indcklll IHnco K-).1-88(243A)
Shklll 1 1000
Adieutp. suriM 0\,e.
Sl*ak.Durres
P-onari

Mirutita 1 Mtgt., et rorCa TOIHote

PI NH₂

I>RUI OKI I toJIU
1\k,(ii.A•L17:RO)ILVRAJ

Nëntor 2016

III.1.1

'...a rtllJ•tl..._•'it!•,, - •

• Jntn=tti:ITm

Chycklet janë bjetërsuan rënë nga fami(jarë)

Kaffes & report it

ing

K)l'ar.II'MIIIII...WI'-*-t'tii'ObfIduo.-c-
 > t>-r.v fTY IIIIM,Jtt;;tfl -_- (tt_II -
 ftkln.t.l,t..t'fWItmint.Fit-dloIII IIIII
cwl.....klyM.fllldJIfldftdlt If'
1'f.....limflll,,,nt....*V,,,,,-,,